

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Agastra Software Solution ” SH.P.K

Sot, më datë 1/12/2021 (dy mije e njezet e nje), **Z. Kevin Agasta**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 21/12/1997, lindur në (Vlore), dhe banues në Tiranë ,Rruga Ali Demi nd 104 hyrja 1 ap 12 , person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pashaportes me id J71221053E Vendosem te themelojme nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas legjislacionit shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat vijuese.

NENI 1
Themelimi

Emri i shoqerise eshte **Agastra Software Solution Sh.P.K**, Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri ” **SH.P.K**, sipas përcaktimeve të bë **Agastra Software Solution** bera në këtë Akt Themelimi dhe Statut.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie eshte Zhvillimi web software aplikacione dhe cdo gje qe ka lidhje me zhvillimet informatike ..

NENI 3

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin " **Agastra Software Solution ” SH.P.K**. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë është: Zhvillim web,software, aplikacione mobile.Analize e kerkesave dhe projektim i sistemit software UI/UX design . Testing dhe QA Studim tregu. Analize dhe sherbime konsulence per bizneset.Sherbime mirbajtje software,web Digjital marketing dhe e-commerce. Analizim dhe shkene te te dhenave.siguri kibernetike:Web inteligjence: Ivestigime, Teknologji per sigurine Compjuter Forensic. Konsulence per bizneset,asistim dhe ndermjetesim ne shitje blerje pasurish te patudshme,asistim ne procesin e regjistrimit te pronave.Cdo operacion te ngjashem dhe te lejuar nga legjislacioni privat

NENI 5


Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në bashkinë Tirane , Adresa Tirane rruga Ali Demi nd 104 hyrja 1 ap 12 zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë dhe Ortaket

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100.000 (nje qind mije) lek, Ortaku themelues z Kevin Agastra te Shoqërisë Tregtare “**Agastra Software Solution ” SH.P.K** zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:- **Z. Kevin Agasta**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 21/12/1997 lindur në (Vlore), dhe banues në Tirane ,Rruga Ali Demi nd 104 hyrja 1 ap 12 mbajtës i pashaportes me id J71221053E


Kevin Agasta

zotërues i kuotave 100 % të përbërë nga 100.000(njëqind mijë) lek, duke përfaqësuar 100 %, të kapitalit Z., Kapitali themeltar është shlyer plotësisht në para nga Ortaket me themelimin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakeve shtrihet deri në shumën e kontributeve të tyre në kapitalin themeltar

NENI 7 Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 8 Administratori

Shoqëria administrohet nga 1 Administratore i cili zgjidhet për një mandat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Administratori i shoqërisë do të jetë Z. Kevin Avagatra shtetas shqiptar i datelindjes 21/12/1997 lindur në (Vlore), dhe banues në Vlore ,Ruga Ali Demi mbajtes i pashaportes me ID J71221053E shtetas Shqiptar,

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, të cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 12

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 13

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 14

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaket Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkruan pa urrejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

**ORTAKU THEMELUES
KEVIN AGASTRA**

Kevin Agastra 